


SQ



**TIEMME *NEXT* >>>**

**SISTEMI I MENAXHIMIT  
TË KOMODITETIT NË SHTËPI**

 **TIEMME**  
ORIGINAL ITALIAN TRADEMARK 




# NGRITENI KOMODITETIN E SHTËPISË TUAJ NË NJË NIVEL TJETER SA MË LEHTË QË MUND TË JETË

## MIRË SE VINI NË SISTEMIN TIEMME NEXT

TIEMME NEXT është sistem i ri i kontrollit që ju lejon të menaxhoni temperaturën e dhomës të themi me sy mbyllur. Sistem që përputhet me disa aplikacione të Automatizimit të Shtëpisë, të tilla si Amazon Alexa ose Google Home, TIEMME NEXT e ngritë komoditetin e shtëpisë tuaj në një nivel tjetër duke kursyer kohë dhe energji. I pajisur me teknologji me ekran me prekje (touch), kohëmatësi ju lejon të planifikoni pa mundim javën, si në modalitetin e ngrohjes ashtu edhe në atë të ftohjes. A jeni gati të dilni jashtë dhe të lini pa e konfiguruar programin? Lojë fëmijësh! Me aplikacionin TIEMME NEXT ju mund të kontrolloni sistemin tuaj të shtëpisë nga kudo, gjithçka që ju nevojitet është një telefon i mençur ose tablet.

Si rezultat i përvojës së madhe në sistemet e ngrohjes dhe ftohjes, TIEMME ka konceptuar një sistem inteligjent qëllimi përfundimtar i të cilit është të përmirësoj mirëqenien tuaj personale, duke optimizuar efikasitetin e energjisë.



# ZGJIDHJA E TREGUT PËR MIRËQENIEN TUAJ NË NJË SISTEM TË PLOTË



## INSTALIM I LEHTË

Instalimi i sistemit TIEMME NEXT është i lehtë dhe i përshtatshëm për përdoruesit: ndiqni udhëzimet në aplikacionin TIEMME NEXT dhe në pak kohë, do të jeni në gjendje të kontrolloni plotësisht temperaturën e shtëpisë tuaj nga telefoni juaj mobil.



## KURSIM ENERGJIE

Me TIEMME NEXT ju mund të kontrolloni ajrin e kondicionuar në secilën dhomë, kështu duke kursyer deri në 30% në faturat tuaja të energjisë pa çënuar komoditetin.



## KOMODITET I PERSONALIZUAR

Me TIEMME NEXT mund të vendosni për temperaturën, lagështinë dhe ventilimin e ajrit në secilën dhomë. Zgjidhjet tona të shumta lejojnë krijimin e nën-zonave të cilat mund të kontrollohen në mënyrë të pavarur nga telefoni juaj mobil.



## THJESHTË DHE SIGURT

TIEMME NEXT, një aplikacion miqësor për përdorim ose edhe asistenti juaj zanor do të ju ndihmojë deri në menaxhimin e sistemit tuaj të kondicionimit të shtëpisë. Nuk ka asgjë më të lehtë se kaq. Mund t'ju dërgohet një njoftim me email në rast alarmi dhe të menaxhoni sistemin edhe jashtë linje. Me të vërtetë i besueshëm dhe i sigurt.



## KONTROLL NGA DISTANCA

Përmes aplikacionit TIEMME NEXT, ju mund të ndizni dhe fikni, rritni ose ulni temperaturën e shtëpisë tuaj nga vendi juaj i punës. Dhe ka edhe më shumë! Integrimi i sistemit TIEMME NEXT me Amazon Alexa ose Google Assistant do t'ju lejojë të kontrolloni sistemin tuaj të kondicionimit të ajrit me një komandë të thjeshtë me zë.



## GAMË E PLOTË

Cilido qoftë lloji i sistemit (radiator, fancoiler, radiant ose CMV) ose pozicionimi (i montuar në mur ose brenda në mur) brenda gamës së TIEMME NEXT ju me siguri do të gjeni zgjidhjen që ju përshtatet më së miri.



# LIDHUNI ME KOMODITETIN E SHTËPISË TUAJ NGA KUDO

## KUR TË VINI HERËT NË SHTËPI DHE DO TË DONI QË TEMPERATURA TË ISHTE TAMAM E DUHUR?

Ju jeni larguar me nxitim dhe keni harruar të rregulloni ose fikni kronotermostatin? Lojë fëmijësh! Me aplikacionin TIEMME NEXT mund të trajtoni sistemin tuaj të shtëpisë nga kudo – gjithçka që ju nevojitet është një telefon i mençur ose një tablet. Aplikacioni TIEMME NEXT është i disponueshëm si në Android ashtu edhe në iOS.




## ÇFARË MUND TË BËNI ME APLIKACIONIN TIEMME NEXT ?


- Kontrolloni statusin e sistemit dhe vendosni një program rregullimi
- Krijoni dhe ndryshoni programet dhe cilësimet
- Menaxhoni kronotermostatet e shumta të instaluar në dhoma ose ndërtesa të ndryshme
- Ndizni/fikni sistemin tuaj të kontrollit të temperaturës në çdo kohë nga kudo
- Përdorni komandat zanore për të kontrolluar sistemin tuaj përmes asistentëve zanorë të tillë si Google Assistant ose Amazon Alexa
- Nëse është e nevojshme, mund ta deaktivizoni plotësisht menaxhimin lokal duke kontrolluar kronotermostatin ekskluzivisht nga aplikacioni.







Në rregull Google, vendos temperaturën e dhomës së ndenjës në 22°C.

 Në rregull, duke vendosur temperaturën e dhomës së ndenjës në 22°C.





# MENAXHONI TEMPERATURËN E SHTËPISË TUAJ ME TINGULLIN E ZËRIT TUAJ

## LEHTË SI TË LUASH MUZIKËN TËNDE TË PREFERUAR

TIEMME NEXT mund të jetë e integruar me asistentët zanorë kryesorë në market. Kjo do të thotë që ju mund të kontrolloni ngrohjen dhe ftohjen duke ndryshuar temperaturën e një ose më shumë zonave në shtëpinë tuaj.




# SHUMË ZGJIDHJE, NJË DHE I VETMI SISTEM

## ÇFARË MUND TË KONTROLLONI ME TIEMME NEXT?

TIEMME NEXT, ju lejon disa zgjidhje të instalimit t'i kontrolloni lokalisht ose në distancë, si:

- Bojler
- Pompë termike
- Dehumidifikues
- Ventilim i kontrolluar mekanikisht
- Sisteme radiante
- Sisteme me radiatorë
- Sisteme me fancoilera
- Pompa qarkulluese


Në mënyrë që kështu, nevojat e të dyja sistemeve, ekzistuese dhe të reja, plotësohen.





# KRIJONI ZONËN TUAJ TË KOMODITETIT


SISTEMI RADIANT NË DYSHEME ME DEHUMIDIFIKUES DHE CMV PËRMES RADIO FREKUENCAVE



TIEMMENEXTRF mund të kontrollojë 3 kanale të radio frekuencave për temperaturë (sistemi radiant), lagështi (dehumidifikuesi) dhe ventiluesi i ajrit (CMV ventilimi i kontrolluar mekanikisht).

# ZGJIDHJA SMART EDHE PËR NGROHJEN TRADICIONALE!

SISTEMI I RADIATORËVE ME KOKË TERMOSTATIKE ELEKTRONIKE DHE MENAXHIM GJENERATORI NDËRMJET RADIO FREKUENCËS




Kronotermostati TIEMME NEXT RF kontrollon, nëpërmjet kokës termostatike art.9556W, radiatorët sipas nevojave tuaja dhe, në të njëjtën kohë, aktivizon ose çaktivizon gjeneratorin duke lejuar një menaxhim inteligjent të konsumit.



# TIEMME NEXT, ZGJIDHJA QË KENI QENË DUKE E KËRKUAR

## E MONUTESHME NË MURI



**9589**  
TIEMME NEXT  
termostat javor me Wi-Fi  
dhe i montueshëm në muri

### KARAKTERISTIKAT KRYESORE

- Menaxhimi i sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes
- Programim javor
- Ekran blu me ndriçim
- Butona me ndriçim me ndjeshmëri të prekjes në anët e ekranit
- Rele dalëse për pompë qarkulluese/bojler/pompë termike
- Mund të rregullohet dhe të menaxhohet në distancë përmes aplikacionit "TIEMME NEXT"
- Komunikim i plotë me Sistemet e Automatizimit të Shtëpisë të kontrolluar me zë siç janë Google Assistant ose Amazon Alexa

Kodi	Energji elektr.	Ngjyra	Komunikimi
957 0201	230 Vac	E bardhë	Wi-fi
957 0211	4 x 1,5 V AA	E bardhë	Wi-fi


### MODEL KONFIGURIMI



ART. 9589



Instalimet elektrike



**9590**  
TIEMME NEXT RF  
termostat javor me sensor  
të integruar të lagështisë  
me Wi-Fi, radio frekuencë  
dhe i montueshëm në muri

### KARAKTERISTIKAT KRYESORE

- Menaxhimi i sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes
- Programim javor
- Menaxhimi i temperaturës, lagështisë dhe CMV me anë të 3 kanaleve të komunikimit me radio frekuencë (pa kabëll)
- Ekran i rregullueshëm në 48 tone të ndryshme të ngjyrave
- Butona me ndriçim me ndjeshmëri të prekjes në anët e ekranit
- Rele dalëse shtesë për pompë qarkulluese/bojler/pompë termike
- Mund të rregullohet dhe të menaxhohet në distancë përmes aplikacionit "TIEMME NEXT"
- Komunikim i plotë me Sistemet e Automatizimit të Shtëpisë të kontrolluar me zë siç janë Google Assistant ose Amazon Alexa

Kodi	Energji elektr.	Ngjyra	Komunikimi
957 0203	230 Vac	E bardhë	Wi-fi + RF

### MODEL KONFIGURIMI



ART. 9590



ART. 4607



Instalimet elektrike


## KUTI KATRORE INSTALIMI E MONTUAR BRENDA NË MUR



**9591**  
**TIEMME NEXT IN**  
kronotermostat javor me  
Wi-Fi dhe montim brenda


### KARAKTERISTIKAT KRYESORE

- Menaxhimi i sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes
- Programim javor
- Përputhet me gamën kryesore domestike të kornizave të tregut Italian (Bticino, Vimar, Gewiss, Ave dhe ABB)
- Rele dalëse për pompë qarkulluese/bojler/pompë termike
- Mund të rregullohet dhe të menaxhohet në distancë përmes aplikacionit "TIEMME NEXT"
- Komunikim i plotë me Sistemet e Automatizimit të Shtëpisë të kontrolluar me zë siç janë Google Assistant ose Amazon Alexa

 Kuti katrore e montueshme brenda

Kodi	Energji elektr.	Ngjyra	Komunikimi
957 0205	230 Vac	E bardhë	Wi-fi

### SHEMBULL I INSTALIMIT



1. Korniza e përparme (\*)
2. Adapter (i përfshirë në paketim art. 9591)
3. **Art. 9591**
4. Korniza e përparme (\*)

(\*) **ABB** (Mylos); **AVE** (S44); **BTICINO** (Axolute, Axolute AIR; Light, Living International, LivingLight, Livinglight AIR); **GEWISS** (Chorus); **VIMAR** (Arkè, Eikon, Eikon Evo, Plana).






## KUTI RRETHORE INSTALIMI E MONTUAR BRENDA NË MUR



**9592**  
**TIEMME NEXT RD**  
kronotermostat javor me  
Wi-Fi dhe montim brenda


### KARAKTERISTIKAT KRYESORE

- Menaxhimi i sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes
- Programim javor
- Përputhet me gamën kryesore të kornizave të rrumbullakëta në seri dhe integruese (Berker, Busch-Jaeger, Gira, Jung dhe Merten)
- Rele dalëse për pompë qarkulluese/bojler/pompë termike
- Mund të rregullohet dhe të menaxhohet në distancë përmes aplikacionit "TIEMME NEXT"
- Komunikim i plotë me Sistemet e Automatizimit të Shtëpisë të kontrolluar me zë siç janë Google Assistant ose Amazon Alexa

 Kuti rrethore e montueshme brenda

Kodi	Energji elektr.	Ngjyra	Komunikimi
957 0207	230 Vac	E bardhë	Wi-fi

### SHEMBULL I INSTALIMIT



1. Art. 9592
2. Korniza e përparme (\*)
3. Korniza e brendshme (\*)
4. Korniza mbyllëse (përfshirë në paketimin e art. 9592)

(\*) BERKER; BUSCH-JAEGER; GIRA; JUNG; MERTEN.









**TIEMME RACCORDERIE S.p.A.**

Via Cavallera, n. 6/A - 25045 Castegnato (BS) - Italy  
Tel. +39 030 2142211 - Fax +39 030 2142206  
info@tiemme.com



Customer Service Fax +39 030 2142254  
customerservice@tiemme.com

[www.tiemme.com](http://www.tiemme.com)



Rev. A - 12 2021